



Rruga “Nikolla Tuce”, Nr. 1, Kati 3
Tiranë, Shqipëri
NIPT: K52311009R
+355 69 60 60 058
www.credinsinvest.com

Raport Mjor për fondin Credins Dynamic

Portofoli i Fondit Credins DYNAMIC, në përputhje me Politikën e Investimit, do të përbëhet kryesisht nga obligacione të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë ose vendeve të Bashkimit Europian të denominuara në monedhën Euro, si dhe kuota të fondeve të investimeve (SIK/ETF).

Data e raportit: 28.02.2026

Informacion për Fondin

Shoqëria Administruese e Fondit:	Credins Invest
Data e lançimit të fondit:	15 shtator 2025
Periudha e akumulimit	15 shtator – 15 tetor 2025
Monedha e Fondit:	Euro

Fondi i adresohet investitorëve që kërkojnë:

- ✓ një normë kthimi më të lartë se produktet bankare në Euro,
- ✓ likuiditetin që i mungon këtyre produkteve.

Profil i rrezikut dhe përfitimit

Ecuria e normës së kthimit të Fondit varet nga lëvizja e normave të interesit obligacioneve dhe të cmimit kuotave të fondeve të investimit ku investon Fondi.

Rrezik i ulët

Rrezik i lartë

Përfitimet tipike më të ulëta

Përfitimet tipike më të larta

1	2	3	4	5	6	7
---	---	---	---	---	---	---

Fondi CREDINS DYNAMIC ka një profil rreziku në nivelin 3, pra të mesëm.

Të dhëna kryesore për Fondin


Vlera Neto e Aseteve	520,877.40 Euro
Çmimi i kuotës	101.2263 Euro
Kthimi nga investimi (15.10.2025 – 28.02.2026)	1.23%

Fondi i Investimit “Credins Dynamic” është fond investimi me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike i emetuar në monedhën Euro. Ky Fond përbën një mundësi investimi për të gjithë investitorët individ apo institucional që kanë një horizont investimi afatmesëm dhe që kërkojnë kthime nga investimi i tyre në monedhën Euro, duke investuar me një profil rreziku të mesëm.

Mbajtësit e kuotave të Fondit janë njëkohësisht pjesëmarrës indirekt në një gamë të gjerë investimesh në vende të BE-së, dhe në sektorë të ndryshëm industrial, duke diversifikuar kështu rrezikun e tregut nëpërmjet administrimit profesional asetave të Fondit.

Shoqëria Administruese synon të krijojë një portofol të balancuar përsa i përket maturitetit dhe gamës së instrumenteve financiare në të cilat investohen asetet e Fondit.

Ekspozimi sipas llojit të instrumentit



Portofoli i Fondit në 31.01.2026

Instrumented kryesore të Portofolit	Alokimi si % Asetesh	Kthimi i muajt Shkurt 2026
Eurobond i Shtetit Shqiptar	28.46%	0.06%
Eurobond i Shtetit Rumun	25.43%	-0.04%
iShares Global Corp Bond EUR Hedged UCITS ETF (Dist)	19.33%	0.94%
SPDR® MSCI All Country World EUR Hdg UCITS ETF (Acc)	18.62%	1.53%

Karakteristikat e rrezikut të asetave në Fond

Depozitat Bankare

Depozita Bankare si klasë asetë përmban rrezikun e kredisë së bankës dhe rrezikun e rikimit në momentin e maturimit të saj. Rreziku i rikimit nënkupton uljen e normës së interesit kur depozita rivendoset me të njëjtin maturitet.

Obligacionet qeveritare

Këto asetë janë të emetuara nga shteti shqiptar në monedhën Euro, ose janë të emetuar ose të garantuara nga autoritete qendrore, rajonale ose vendore të BE-së, ose nga çdo shtet i miratuar nga AMF në monedhën Euro të tregtuara në tregje të rregulluara ndërkombëtare. Obligacionet qeveritare janë subjekt i rrezikut nga normat e interesit dhe kanë nota krediti (“rating”) të ndryshme.

Kuota të fondeve të investimeve (SIK/ETF)

Kuota të fondeve të investimeve (SIK) ose të fondeve të investimeve të tregtuara në bursë (ETF) janë kuota fondesh të cilat i përmbahen një politike investimi dhe riskut të përcaktuar. Këto instrumente ekspozohen nga risku i luhatshmerisë të cmimit dhe mbartin riskun e totalit të instrumenteve që formojnë portofolin e këtyre fondeve.

*Për më tepër informacion rreth rreziqeve të Fondit, ju lutem referojuni seksionit përkatës në Prospektin e Fondit Credins Dynamic.



Rruga "Nikolla Tupe", Nr. 1, Kati 3
Tiranë, Shqipëri
NIPT: K52311009R
+355 69 60 60 058
www.credinsinvest.com

Informacion për Fondet e investimit të tregtuara në busë (SIKTT) që janë pjesë e portofolit të Fondit Credins Dynamic

iShares Global Corp Bond EUR Hedged UCITS ETF (Dist) është një Fond i Tregtuar në Bursë i regjistruar në Irlandë, i nisur në vitin 2013, me një NAV prej 1,170.20 milionë EUR (në datë 28.02.2026). Fondi ka si qëllim të ndjekë performancën e një indeksi të përbërë nga obligacione korporate të kategorisë "investment grade" nga lëshues të obligacioneve në tregje në zhvillim dhe të zhvilluara.

Emetuesit kryesorë janë: Jpmorgan Chase & Co 1.40%, Bank Of America Corp 1.34%, Morgan Stanley 1.24%, Goldman Sachs Group Inc 1.11%, me ekspozim dominues prej 25.55% në sektorin e industrisë bankare.

SPDR MSCI All Country World UCITS ETF (Acc) EUR-Hedged: Fondi është një Fond i Tregtuar në Bursë (ETF) i regjistruar në Irlandë, me monedhë baze USD, i mbrojtur në EUR, lançuar në vitin 2019, me një NAV prej 1,088.40 milionë USD (në datë 28.02.2026).

Qëllimi i Fondit është të ndjekë performancën e tregut të aksioneve në tregjet e zhvilluara dhe ato në zhvillim. Fondi është i listuar në busat: Deutsche Börse, Borsa Italiana, SIX Swiss Exchange.

Aksionet kryesore përfshijnë: Nvidia Corp 4.45%, Apple Inc 4.01%, Microsoft Corp 2.85%, Amazon.Com Inc. 2.07%, me një ekspozim


dominues prej 26.21% në sektorin e industrisë së Teknologjisë së Informacionit, dhe një ekspozim gjeografik kryesor në SHBA, ku mbahet 62% e aksioneve.

Kostot dhe Tarifat

Tarifat përdoren për të paguar kostot e administrimit të Fondit, duke përfshirë tarifën e administrimit të Shoqërisë Administruese, tarifën e depozitarit, tarifën e AMF, kostot e auditimit vjetor të Fondit, kostot të transaksioneve, etj, si në tabelën e mëposhtme. Tarifa e koston e administrimit dhe të gjitha kostot e tjera të listuara në një vit kontabël nuk do të tejkalojnë në asnjë rast maksimumin prej 3.5% të vlerës neto të aseteve të fondit.

Tarifa e hyrjes apo daljes	0%
Tarifa e administrimit	1.5% në vit e VNA të Fondit
Komisione/tarifa nga shlyerja e kuotave	Tërheqje brenda vitit të parë: 1.5% e vlerës së tërhequr Pas vitit të parë: Nuk ka tarifë dalëse
Kosto të transaksioneve për investimin e aseteve të fondit	Sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese
Tarifa të tjera të vazhdueshme	Referojuni prospektit të fondit
Tarifa e AMF	0.05% në vit e VNA

Performanca e Fondit Credins Dynamic



Performanca e kaluar nuk është një udhëzues, premtim apo garanci për performancën e ardhshme dhe nuk duhet të jetë faktori i vetëm i shqyrtimit gjatë zgjedhjes së një produkti. Të gjitha investimet financiare përfshijnë një element të rrezikut. Prandaj, vlera e investimit tuaj dhe të ardhurat nga ajo do të ndryshojnë. Nivelet dhe bazat e taksimit mund të ndryshojnë herë pas here. Për informacion shtesë, jeni të fuar të lexoni Prospektin e Fondit si dhe të vizitoni faqen zyrtare të shoqërisë www.credinsinvest.com.